Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија" бр. 58/00, 44/02, 82/08,167/10 и 51/11) и член 22 став 1 од Законот за средното образование („Службен весник на Република Македонија" бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 и 64/18), министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по наставниот предмет ***музичка култура*** за **I (прва) година** од средното стручно образование со четиригодишно траење.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

Programi mësimor

# KULTURA MUZIKORE

dizajn modular

për vitin I

*të gjitha profilet arsimore/kualifikimet*

*të gjitha drejtimet/sektorët*

Shkup, viti 2019

| | |
|---|---|
| **Titulli i programit mësimor** | Kultura muzikore |
| **Lloji i programit mësimor** | I obligueshëm |
| **Vlera kreditore e programit mësimor** | 2 (dy) kredi ECVET[1] |
| **Drejtimi** | Të gjitha drejtimet |
| **Sektori** | Të gjitha drejtimet |
| **Profili arsimor** | Të gjitha profilet arsimore |
| **Titulli dhe niveli i kualifikimit** | Të gjitha kualifikimet<br><br>Niveli 4 (i katërt) |
| **Viti shkollor** | Viti I (i parë) |
| **Numri i orëve në javë/vit për realizimin e programit mësimor** | 1 / 36 |
| **Qëllimet e programit mësimor** | Nxënësi/nxënësja të fitojë njohuri dhe shkathtësi për:<br>- rolin dhe zhvillimin e muzikës nëpër histori;<br>- dëgjimin aktiv të muzikës;<br>- njohjen e karakteristikave të epokave të ndryshme në muzikën e dëgjuar;<br>- karakteristikat themelore të traditës muzikore dhe zakoneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut;<br>- njohuritë themelore për ndikimin e muzikës mbi personalitetin.<br>Me mësimin e lëndës mësimore *Kultura muzikore,* i riu do të aftësohet të marrë qëndrim kritik duke bërë dallim të |

[1] Ligji për Kornizën nacionale të kualifikimeve.

| | |
|---|---|
| | qartë mes: veprave muzikore me vlerë artistike/estetike dhe muzikës komerciale dhe të porositur. |
| **Njësitë modulare të programit mësimor** | • MUZIKA NËPËR HISTORI<br>• TRADITA DHE ZAKONET MUZIKORE<br><br>VËREJTJE: Arsimtari çdoherë mund të bëjë përzgjedhjen e vet për kompozimet për dëgjim, me qëllim që të arrihet rezultati i dhënë nga mësimi, në përputhje me kushtet për mësim. |
| **Kushtet materiale-teknike dhe hapësinore** | Për arritjen e qëllimeve të mësimit në lëndën e kulturës muzikore nevojitet zbatimi shkencërisht i menduar dhe planifikuar i mjeteve të ndryshme mësimore si dhe kabinete të pajisura muzikore me mjetet mësimore vijuese: sistem muzikor, televizor, DVD, kompjuter me pakete adekuatë softuerike me programe muzikore, Smart–tabelë, fonotekë (koleksion i audio-video CD-ve), instrumente muzikore etj. Për realizim të suksesshëm dhe të plotë të programit mësimor nevojitet organizimi i aktiviteteve që e ndryshojnë vendin e realizimit të orës/orëve (institucione të kulturës dhe institucione tjera) ku nxënësit do të vizitojnë ngjarje: koncert, operë, balet, dhe ngjarje tjera muzikore. Shembull vizitë në Filarmoninë maqedonase, Operës dhe baletit maqedonas, Institucionit nacional Ansambli i valleve popullore dhe këngëve „Tanec“ ose shoqatave tjera kulturore-artistike dhe institucioneve kulturore. |
| **Normativi i kuadrit mësimor** | Mësimin në lëndën *Kultura muzikore* mund ta mbajë personi i cili ka kryer:<br>- studime të artit muzikor–seksioni për teori muzikore dhe pedagogji, VII/1 ose VIA sipas KNK dhe 240 ECTS;<br>- studime të artit muzikor, seksionet tjera, VII/1 ose VIA sipas KNK dhe 240 ECTS, dhe me përgatitje<br>Pedagogjike-psikologjike dhe metodike të fituar në institucione të akredituara të arsimit të lartë. |

| | Njësia modulare 1. MUZIKA NËPËR HISTORI (24 orë) | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. rendor | Rezultatet nga të mësuarit | Përmbajtjet dhe nocionet | Aktivitetet dhe metodat | Kriteret e vlerësimit* |
| 1 | **Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:**<br>- sqarojë për vendin dhe rolin e muzikës në shoqëri;<br>- diskutoje për ndikimin e muzikës mbi njeriun dhe disponimin e tij; | **Vendi dhe roli i muzikës në shoqëri**<br>**Nocionet:**<br>-autori/kompozitori<br>-interpretuesi<br>-publiku<br>-ngjarjet muzikore | **Aktivitetet:**<br>-Diskutimi për vendin dhe rolin e muzikës në shoqëri;<br>- Debaton për ndikimin e muzikës mbi njeriun dhe disponimin e tij nëpërmjet dëgjimit të muzikës.<br><br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda)<br>▪ Prezantimi. | **Nxënësi/nxënësja mund të:**<br>1.1 sqarojë për vendin dhe rolin e muzikës në shoqëri;<br>1.2 shprehet me fjalë të veta për ndikimin e muzikës në jetën e të rinjve;<br>1.3 diskutojë për muzikën e dëgjuar për zhvillimin e ndjenjave të ndryshme që shkaktohen nga e njëjta. |
| 2 | - sqarojë për muzikën e Renesancës nëpërmjet krahasimit me veprat e artit të Renesancës;<br>- bëjë dallim mes muzikës së shenjtë dhe shpirtërore;<br>- diskutojë për përfaqësuesit e Renesancës muzikore;<br>- njohë instrumentet nga Renesanca; | Epokat muzikore:<br>**Muzika e Renesancës**<br>-Xhovani Pjerluigji de Palestrina<br>-Orlano di Laso<br><br>**Nocionet:**<br>-madrigali<br>-misa | **Aktivitetet:**<br>- Dëgjimi i muzikës: „Matona mia cara“<br>(biseda për veprën e dëgjuar muzikore).<br>-Biseda për paraqitjen e muzikës së Renesancës dhe krahasimi me veprat e artit të Renesancës (zbatimi i TIK); | 2.1. theksojë të dhëna për paraqitjen e muzikës së Renesancës dhe bëjë krahasim me veprat e artit të Renesancës;<br>2.2. numërojë karakteristikat themelore të muzikës së Renesancës;<br>2.3. arsyetojë shkaqet e paraqitjes |

* Janë vendosur standarde/indikatorë për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | -lahuta<br>-organo | - Njohja me instrumentet e Renesancës dhe njohja e tyre nëpërmjet zbatimit të TIK<br>- Aktiviteti i projektit: përgatitja e albumit të kompozitorëve dhe instrumenteve nga Renesanca.<br><br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda)<br>▪ Diskutimi me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi. | së muzikës shpirtërore dhe të shenjtë;<br>2.4. japë një rezyme të shkurtër për jetën dhe veprat e kompozitorëve nga Renesanca; |
| 3 | - paraqesë të dhëna për Barokun muzikor;<br>- sqarojë për muzikën e Barokut;<br>- diskutojë për përfaqësuesit e Barokut muzikor;<br>- bëjë krahasim mes jetës dhe krijimtarisë së-Johan Sebastian Bahut dhe Gerog Fridrih Hendlit<br>- njohë me shikim dhe me dëgjim instrumentet e Barokut; | **Baroku në muzikë**<br>- Johan Sebastian Bah<br>- Georg Fridrih Hendl<br><br>**Nocionet:**<br>-Fuga<br>-Oratoriumi<br>-Çembalo<br>-Violina | **Aktivitetet:**<br>- Dëgjimi i fragmenteve nga:<br>J.S.Bah „Tokata dhe fuga në d-mol“<br>G.F.Hendl, oratorium „Mesija“(„Aleluja“)<br><br>- Biseda për paraqitjen e Barokut dhe krahasimi me veprat e artit të Barokut (zbatimi i TIK);<br>-Krahasimi mes jetës dhe krijimtarisë së - Johan sebastian Bahut dhe Geor Fridrih Hendlit;<br>- Diskutim për operën serioze dhe komike;<br>- Aktiviteti i projektit: përgatitja e albumit të kompozitorëve dhe instrumenteve nga Baroku. | 3.1. paraqesë të dhëna për paraqitjen e Barokut muzikor;<br>3.2. përshkruajë për paraqitjen e muzikës së Barokut nëpërmjet krahasimit me veprat e artit të Barokut;<br>3.3. dëgjojë në mënyrë aktive dhe diskutojë për përfaqësuesit e Barokut muzikor (rezyme e shkurtër për jetën dhe krijimtarinë e kompozitorëve dhe krahasimi e jetës dhe veprës së Bahut dhe Hendlit);<br>3.4. diskutojë për paraqitjen e operës (opera serioze dhe komike) nëpërmjet zbatimit të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | **Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi. | TIK;<br>3.5. bëjë dallim të instrumenteve nga Renesanca dhe Baroku. |
| 4 | -sqarojë për rolin e muzikës në Klasicizëm;<br>- diskutojë për përfaqësuesit e Klasicizmit (Hajdn, Mocart dhe Betoven);<br>- njohë instrumentet nga epoka e Klasicizmit (në mënyrë auditive dhe vizuale);<br>- diskuton për paraqitjen e simfonisë; | **Klasicizmi:**<br>- Franc Jozef Hajdn<br>- Volfgang Amadeus Mocart<br>- Ludvig van Betoven<br><br>**Nocionet:**<br>- Simfonia<br>- Orkestra simfonike | **Aktivitetet:**<br>**Dëgjimi i muzikës** -fragmente:<br>Franc Jozef Hajdn: Fragment nga kuarteti harkor<br>- Volfgang Amadeus Mocart-Aria nga opera „Flauta magjike"<br>-Ludvig van Betoven (simfonia e pestë, paragrafi I).<br><br>- Diskutimi për paraqitjen e Klasicizmit muzikor<br>- Skema e vendosjes së orkestrës simfonike<br>- Rregullimi i panelit për jetën dhe krijimtarinë e kompozitorëve nga ajo periudhë.<br><br>- Aktiviteti i projektit: përgatitja e albumit të kompozitorëve dhe instrumenteve nga Klasicizmi.<br><br>**Metodat:** | 4.1. tregojë shkaqet e ndryshimeve që sjellin deri te paraqitja e Klasicizmit;<br>4.2. sqarojë për jetën dhe krijimtarinë e përfaqësuesve të Klasicizmit;<br>4.3. bëjë krahasim mes tre përfaqësuesve të Klasicizmit muzikor: Hajdn, Mocart dhe Betoven;<br>4.4. sqarojë për simfoninë dhe orkestrën simfonike. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | ▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi. | |
| 5 | - paraqesë karakteristikat e Romantizmit muzikor;<br>- sqarojë për muzikën në Romantizëm;<br>- numërojë përfaqësuesit e Romantizmit muzikor;<br>- njohë grupet interpretuese nga epoka e Romantizmit;<br>- diskutojë për paraqitjen e solo këndimit dhe poemës simfonike; | **Romantizmi muzikor**<br>- Franc Shubert<br>- Bedzhih Smetana<br>- Petar Iliç Çajkovski<br><br>**Nocionet:**<br>- Solo këndimi<br>- Poema simfonike<br>- Koncerti<br>- Baleti | **Aktivitetet:**<br>-**Dëgjimi i muzikës:**<br>Franc Shubert-„Ave Marija"<br>Bedzhih Smetana, poema simfonike „Vlltava" dhe vepra tjera sipas përzgjedhjes së arsimtarit<br>- Fjalim/bisedë për paraqitjen e Romantizmit muzikor<br>- Aktiviteti i projektit: përgatitja e albumit të kompozitorëve dhe instrumenteve nga Romantizmi muzikor.<br><br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi. | 5.1 .paraqesë karakteristikat e muzikës në periudhën e Romantizmit muzikor;<br>5.2. numërojë përfaqësuesit e Romantizmit muzikor nëpërmjet burimeve audio-vizuale;<br>5.3. sqarojë karakteristikat themelore të solo këngës, poemës simfonike, koncertit dhe baletit. |
| 6 | - paraqesë karakteristikat për operën në Romantizëm;<br>- sqarojë për përmbajtjen e operës në Romantizëm;<br>- njohë fragmente nga krijimtaria e | **Opera në romantizëm dhe përfaqësuesit e saj**<br>-Xhuzepe Verdi<br>- Xhoakino Rosini<br>- Rihard Vagner | **Aktivitetet:**<br>**Dëgjimi i muzikës**-fragmente:<br><br>Xhuzepe Verdi:„Aida"– marshi | 6.1. theksojë cilat janë karakteristikat e operës në Romantizëm;<br>6.2. diskutojë për rolin e uvertirës, arisë dhe pjesëve tjera të operës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | o pers në Romantizëm;<br>- diskutojë për karakteristikat e operës dhe operën;<br>- numërojë përfaqësuesit e operës në Romantizëm; | - Zhorzh Bize<br><br>**Nocionet:**<br>- Uvertira<br>- Aria | triumfues<br><br>Xhoakino Rosini: uvertira„Berberi i Sevilës "<br><br>Rihard Vagner: opera„Valkiri"-vallja e Valkirëve<br><br>Zhorzh Bize:„Karmen "<br><br>- Fjalim/bisedë për paraqitjen e Romantizmit muzikor<br>- Debat për veprat e dëgjuara.<br><br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi. | në Romantizëm;<br>6.3. sqarojë për nocionet uvertura dhe aria;<br>6.4. tregojë për jetën dhe krijimtarinë e përfaqësuesve të operës në Romantizëm. |
| 7 | - sqarojë për paraqitjen e Impresionizmit;<br>- paraqesë të dhëna për Impresionizmin muzikor;<br>- diskutojë për përfaqësuesit e Impresionizmit muzikor;<br>- njohë krijimet muzikore nga epoka e Impresionizmit;<br>- diskutojë për lidhjen e Impresionizmit muzikor me atë të artit figurativ; | **Impresionizmi muzikor dhe përfaqësuesit e tij:**<br>- Klod Debisi<br>- Moris Ravel<br><br>**Nocionet:**<br>- Arabeska<br>- Bolero | **Dëgjimi i muzikës**-fragmentet:<br><br>Klod Debisi–„Hëna e pastër"<br>Moris Ravel–„Bolero" - fragment.<br><br>**Aktivitetet:**<br>- Diskutimi për paraqitjen e impresionizmit muzikor me integrimin nëpërmjet artit figurativ;<br>- Analiza e veprave të dëgjuara.<br>**Metodat:** | 7.1. sqarojë për paraqitjen e Impresionizmit nëpërmjet artit figurativ dhe letërsisë;<br>7.2. paraqesë karakteristikat e muzikës në periudhën e Impresionizmit;<br>7.3. shpjegojë për jetën dhe krijimtarinë e përfaqësuesve të Impresionizmit muzikor;<br>7.4. sqarojë or nocionet arabeska dhe bolero; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | ▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi. | 7.5. merr pjesë në debat për veprat e dëgjuara. |
| 8. | - paraqesë të dhëna për muzikën e shekulli XX;<br>- diskutojë për përfaqësuesit e muzikës së shekullit XX;<br>- njohë përbërjet interpretuese të muzikës së shekullit XX; | **Muzika e shekullit XX:**<br>- Igor Stravinski:<br>- Karl Orf<br><br>**Nocionet:**<br><br>-kantata skenike | **Aktivitetet:**<br>- Igor Stravinski: „Dedikimi i pranverës"<br>- Karl Org: „Karmina burana" – O fortuna!<br>- Njohja me përfaqësuesit e muzikës së shekullit XX.<br><br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi. | 8.1. numërojë karakteristikat e muzikës së shekullit XX;<br>8.2. rrëfejë për jetën dhe krijimtarinë e përfaqësuesve të shekullit XX;<br>8.3. analizojë veprat e dëgjuara në pyetjet e parashtruara. |
| 9. | - paraqesë të dhënat për veprimtarët e parë muzikor në Maqedoni;<br>- sqarojë për mbledhjen e artit popullor dhe melografimi;<br>- njohë krijimtarinë dëgjuese të veprimtarëve të parë muzikorë në Maqedoni; | **Veprimtarët e parë muzikorë nga Maqedonia**<br>Jovan (Jan) Kukuzel<br>Atanas Badev<br>Naum Miladinov<br><br>**Nocionet:**<br>- Liturgjia<br>- Melografimi | **Aktivitetet:**<br>Dëgjimi i muzikës-fragmente nën përzgjedhjen e arsimtarit<br>- Bisedë për muzikën në Maqedoni në fund të shekullit XIX me integrim nëpërmjet poezisë dhe historisë popullore.<br><br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK) | 9.1. sqarojë për karakteristikat e muzikës së veprimtarëve të parë muzikorë në Maqedoni;<br>9.2. njohë interpretimin vokal të veprave dëgjuese te veprimtarët e parë muzikorë në Maqedoni;<br>9.3. diskutojë për ruajtjen e krijimtarisë nëpërmjet melografimit të veprave. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | ▪ Prezantimi. | |
| 10. | - numërojë fakte për muzikën në Maqedoni në shekullin XX dhe XXI;<br>- diskutojë për përfaqësuesit e muzikës në Maqedoni dhe kompozitorët nga bashkësitë tjera në shekullin XX dhe XXI;<br>- diskuton për paraqitjen e muzikës korale, operës, baletit dhe formave tjera muzikor në Maqedoni në shekullin XX dhe XXI. | **Muzika në Maqedoni në shekullin XX dhe XXI**<br>Todor Saklovski<br>Kiril Makedonski<br>Trajko Prokopiev<br>Fatos Lumani<br>Vullnet Tairi<br>**Nocionet:**<br>- Muzika Korale<br>- Opera<br>- Baleti | **Aktivitetet:**<br>**Dëgjimi i muzikës**–fragmentet;<br>- Todor Skalovski - „Vallja maqedonase";<br>- Kiril Makedonski–„Mbreti Samoil";<br>- Trajko Prokopiev–„Labini dhe Dojrana";<br>- Fatos Lumani: „Koncert për piano dhe orkestër" (fragmente)<br>- Vullnet Tairi: Kuinteti (fragmente).<br>- fjalim/prezantim për jetën dhe krijimtarinë e kompozitorëve në Maqedoni dhe kompozitorëve nga bashkësitë tjera nga shekulli XX dhe XXI.<br>- Aktiviteti i projektit: përgatitja e albumit të përfaqësuesve të muzikës në Maqedoni dhe kompozitorët e bashkësive tjera në shekullin XX dhe XXI.<br><br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Burimet audio-vizuale të informacioneve dhe prezantimi. | 10.1. Sqarojë karakteristikat e muzikës në Maqedoni në shekullin XX dhe XXI;<br>10.2. Diskutojë për përfaqësuesit e muzikës në Maqedoni dhe kompozitorët e bashkësive tjera në shekullin XX dhe XXI;<br>10.3. dallojë nëpërmjet prezantimit audio-vizual muzikën korale, operën, baletin dhe veprat tjera. |
| 11. | - numërojë zhanret e popullarizuara | **Zhanret dhe instrumentet e** | **Aktivitetet:** | 11. 1. sqarojë nocionin subkulturë; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | në shekullin XX dhe XXI;<br>- diskutojë për lidhjen e muzikës me teknologjinë;<br>- diskutojë për subkulturat muzikore;<br>- njohë etno-elementet në zhanret e popullarizuara. | **popullarizuara në shekullin XX dhe XXI**<br><br>Muzika dhe teknologjia<br>Multimedia<br>Subkulturat muzikore<br>Instrumentet në muzikën moderne<br>Etno-elementet në zhanret e popullarizuara<br><br>**Nocionet:**<br>- Multimedia<br>- Subkultura<br>- Xhazi<br>- Bluzi<br>- Popi<br>- Roku<br>- Repi<br>- Muzika elektronike<br>- Kitara elektrike<br>- Sintisajzeri<br>- Tupanët etj. | - Dëgjimi i kompozimeve nga zhanret e popullarizuara<br>- Këndimi në bazë të shembujve të dëgjuar<br>- Biseda për muzikën e popullarizuar në shekullin XX dhe XXI;<br>- Debati për paraqitjen e stileve dhe zhanreve të ndryshme në muzikën bashkëkohore në shekullin XX dhe XXI;<br>- Interpreton (këndon/luan në instrument) kompozime të njohura/refrene nga zhanret e pranishme në shekullin XX dhe XXI.<br>- Aktiviteti i projektit: përgatitja e albumit të kompozitorëve dhe instrumenteve nga XX dhe XXI.<br><br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi<br>▪ Interpretimi | 11.2. arsyetojë qëllimin e ekzistencës së muzikës në subkultura;<br>11.3. njohë kompozime me etno-elemente;<br>11.4. njohë dhe sqarojë për zbatimin e teknologjisë në muzikë; |

| Njësia modulare 2. TRADITA DHE ZAKONET MUZIKORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT ( 12 orë ) | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **Rezultatet nga të mësuarit** | **Përmbajtjet dhe nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Kriteret e vlerësimit*** |
| 1 | **Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:**<br>- sqarojë karakteristikat e traditës muzikore dhe zakoneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut; | **Karakteristikat themelore të traditës muzikore dhe zakoneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut**<br><br>**Nocionet:**<br>- Tradita<br>- Zakone | **Aktivitetet:**<br>- Diskutim për karakteristikat themelore të traditës dhe zakoneve muzikore te qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si dhe të gjithë qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj.<br>- Prezantimi i karakteristikave themelore të traditës dhe zakoneve muzikore te qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj.<br><br>- Aktiviteti i projektit: përgatitja e | **Nxënësi/nxënësja mund të:**<br>1.1 njohë llojet e këngëve<br>1.2 numërojë llojet e valleve<br>1.3 sqarojë ritmin e këngëve dhe valleve<br>1.4 dallojë instrumentet dhe krijimet sqarojë muzikën në zakonet e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, popullit maqedonas, si dhe qytetarëve që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj. |

* Janë vendosur standarde/indikatorë për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | albumit të përfaqësuesve të muzikës së shekullit XX dhe XXI, te qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj.<br><br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi | |
| 2 | - sqarojë për procesin e krijimit, bartjes dhe ndarjes së këngës popullore;<br>- dallojë karakteristikat e përgjithshme të këngës popullore (burimore, e vjetër qytetare);<br><br>- dallojë këngën popullore të sapokrijuar (autoriale dhe popullarizuar); | **Kënga popullore**<br>(popullore e vjetër qytetare)<br><br>**Kënga popullore e sapoformuar**<br>(autoriale dhe e popullarizuar)<br><br><br>**Nocionet:**<br>- Kënga burimore<br>- Kënga e vjetër qytetare<br>- Kënga autoriale<br>- Kënga e popullarizuar<br>- Kënga e sapokrijuara. | **Aktivitetet:**<br>- Prezantimi audio-vizual i këngëve popullore dhe këngëve të sapokrijuara<br>- Interpretimi vokal i këngëve popullore dhe këngëve të sapokrijuara<br>- Diskutimi për përmbajtjen e këngëve popullore<br>- Debati për llojet e këngëve popullore te qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e | 2.1 bisedojë për karakteristikat e këngës popullore (burimore, të vjetër qytetare);<br>2.2. interpretojë këngën popullore burimore, të vjetër qytetare, të sapokrijuar (sipas zgjedhjes së nxënësit/nxënëses);<br>2.3. dallojë këngën popullore të sapokrijuar (autoriale dhe të popullarizuar);<br>2.4. identifikojë këngët sipas përmbajtjes dhe dedikimit.<br>2.5. krahasojë këngët popullore te qytetarët e Republikës së Maqedonisë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj.<br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi | së Veriut, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj. |
| 3 | - sqarojë ndarjen e instrumenteve popullore;<br>- njohë instrumentet popullore në bazë të mënyrës së interpretimit;<br>- bëjë krahasimin e instrumenteve muzikore sipas zërit; | **Instrumentet muzikore popullore dhe ndarja e tyre**<br><br>- **Instrumentet popullore goditëse**<br><br>- **Instrumentet popullore fryrëse**<br><br>- **Instrumentet popullore me tela**<br><br>**Nocionet:**<br>- Tupani,<br>- Defi,<br>- Tarabuka<br>- Kavalli,<br>- Gajda,<br>- Zurla<br>- Violina | **Aktivitetet:**<br>- Prezantimi audio-vizual i instrumenteve popullore sipas zgjedhjes së arsimtarit dhe nxënësit;<br>- Biseda për mënyrën e përpunimit të instrumenteve popullore dhe zbatimi i tyre<br>- Përpunimi i albumit të instrumenteve muzikore popullore;<br>- Dallon instrumentet popullore, përfaqësimi i tyre në muzikën popullore dhe traditat e ndryshme popullore te qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, | 3.1 njohë instrumentet muzikore;<br>3.2. sqarojë për mënyrën e përpunimit të llojeve të ndryshme të instrumenteve popullore;<br>3.3. bëjë krahasimin e instrumenteve popullore sipas zërit;<br>3.4. dallojë dhe krahasojë instrumentet popullore në traditat e ndryshme popullore te qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | - Kanoni<br>- Mandolina | boshnjak etj.<br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi | |
| 4 | - sqarojë për ndarjen e valleve popullore;<br>- njohë vallet popullore sipas mënyrës së interpretimit;<br>- bëjë krahasimin e valleve popullore sipas mënyrës së luajtjes; | **Tradita popullore e udhëheqjes së valles**<br><br>- Vallet popullore;<br><br>**Nocionet:**<br>- Ritmi<br>- Takti | **Aktivitetet:**<br>- Prezantimi audio-vizual i llojeve të valleve;<br>- Biseda për mënyrën e interpretimit të valleve;<br>- Diskutimi për traditën e udhëheqjes së valles te qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj.;<br>- Interpretim grupor i valleve popullore (sipas zgjedhjes së nxënësve);<br>- Përpunimi i albumit të valleve popullore.<br><br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason | 4.1 njohë vallet popullore;<br>4.2. sqarojë mënyrën e luajtjes e llojeve të ndryshme të valleve popullore;<br>4.3. dëgjojë dhe krahasojë vallet popullore sipas zërit;<br>4.4. diskutojë për vallet te qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj.; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK)<br>▪ Prezantimi | |
| 5 | - njohë traditën dhe zakonet te qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, popullit maqedonas, si dhe qytetarëve që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj.;<br>- krahasojë dhe diskutojë për dallimet dhe ngjashmëritë e traditës dhe zakoneve te popujt e ndryshëm. | **Vlera dhe rëndësia e muzikës dhe tradicionale dhe zakoneve**<br><br>**Nocionet:**<br>- Folklori<br>- Festivali | **Aktivitetet:**<br>- Debati për vlerën dhe rëndësinë e muzikës tradicionale dhe zakoneve nëpërmjet:<br>Prezantimeve audio-vizuale të festivaleve folklorike;<br>Mini-projekteve ose traditat dhe zakonet në Republikën e Maqedonisë së Veriut;<br>- Trashëgimia kulturore jo materiale nga Republika e Maqedonisë së Veriut e mbrojtur nga UNESKO:<br>1. Zakoni „Çetërse" nga Shtipi<br>2. Kopaçkata-valle sociale nga f. Dramçe Pijanec<br>3. Këndimi i zëshëm mashkullor me dy zëra nga Pollogu i ulët<br>4. Hidrellez, festimi pranveror te turqit në Republikën e Maqedonisë së Veriut<br>5. Praktikat kulturore lidhur me 1 marsin (Martinkat)<br>**Metodat:**<br>▪ E dialogut ose bisedës (pas muzikës së dëgjuar pason | 5.1. diskutojë për vlerat dhe rëndësinë e muzikës dhe zakoneve tradicionale;<br>5.2. dallojë pasurinë kulturore dhe materiale te qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vlleh, serb, rom, boshnjak etj.;<br>5.3. prezantojë mini-projekte për traditën dhe zakonet në Republikën e Maqedonisë së Veriut;<br>5.4. numërojë shembuj për trashëgiminë kulturore jo materiale nga Republika e Maqedonisë së Veriut të mbrojtur nga UNESKO. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | diskutimi, dialogu, biseda me zbatimin e TIK) | |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i arritjeve të nxënësve** | Gjatë mësimit rregullisht të përcillen dhe vlerësohen arritjet e nxënësve, mblidhen treguesit e aktiviteteve të tyre, motivimi për shprehje muzikore, angazhimi, përkushtimi në punë si dhe puna ekipore. Gjatë përcjelljes së arritjeve të nxënësve, arsimtari duhet në veçanti të ketë kujdes në qasjen individuale në arritjet e secilit nxënës. Në vazhdimësi t'i përcjellë, vlerësojë dhe notojë aktivitetet, kreativitetin e nxënësit dhe implementimin e diturive të tij, sjelljen e nxënësit dhe rezultatet e arritura në fushën e diturive dhe njohurive dhe ndryshimeve pozitive në karakterin dhe personalitetin e nxënësit. Për kontroll të arritjeve të rezultateve nga mësimi do të përdoren kontrollet me gojë dhe me shkrim, fletët mësimore (kontroll i temës) dhe mjetet, procedurat dhe metodat tjera, p.sh. instrumentet për vlerësim (listat kontrolluese, shkalla deskriptive, analitike etj.), informacioni kthyes (me gojë dhe shkrim) etj. Gjatë vitit shkollor nxënësit vlerësohen së paku me dy nota në një gjymëvjetor, ndërsa përfundohen nota e gjysmëvjetorit dhe ajo vjetore. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve do të jetë me notë numerike (prej 1 deri në 5). |
| **Literatura dhe burimet e tjera** | Teksti/tekstet mësimore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe burime tjera për mësim. |
| **Fillimi i zbatimit të programit mësimor** | Viti shkollor 2019/2020 |
| **Institucioni/<br>Bartësi i programit** | Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) |

| | |
|---|---|
| Потпис и датум на донесување на наставната програма | бр. 13-4390/18<br>11.6.2019 година<br><br>МИНИСТЕР, с.р.<br>Dr. Arbër Ademi<br>____________________________ |
| Датум на ревизија | |